

V E N D I M
Nr. 112, datë 19.2.1998

PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TË LUFTËS KUNDËR DROGËS

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.7504, datë 30.7.1991 "Për policinë e rendit", me propozimin e Ministrisë së Brendshme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijohet Shërbimi i luftës kundër drogës, si shërbim i përqendruar dhe i specializuar, gjurmues-hetimor i policisë kriminale për kërkimin, konstatimin, zbulimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të trafikut, prodhimit, shpërndarjes, shitjes dhe transportimit të drogës, si dhe të kultivimit të bimëve narkotike.

1. Shërbimi i luftës kundër drogës organizohet në:

-shërbim qendror i luftës kundër drogës në përbërje të Drejtorisë së Policisë Kriminale;

-zyrat rajonale të luftës kundër drogës që funksionojnë pranë drejtorive të policisë në prefektura.

3. Shërbimi qendror i luftës kundër drogës ka në përbërje të tij zyrën e luftës kundër trafikut dhe zyrën e luftës kundër kultivimit dhe prodhimit të saj. Detyrat funksionale dhe kompetencat e tyre përcaktohen me urdhër të veçantë të Ministrit të Brendshëm.

4. Zyrat rajonale të luftës kundër drogës, për funksionet që do të kryejnë në zbatim të detyrave të tyre, janë në varësi të drejtpërdrejtë të Shërbimit qendror të luftës kundër drogës në Drejtorinë e Policisë Kriminale të Ministrisë së Brendshme.

Detyrat funksionale të tyre dhe kompetencat përcaktohen me urdhër të Ministrit të Brendshëm.

5. Ministritë dhe strukturat e tjera qendrore të administratës shtetërore që lidhen me problemet e luftës kundër drogës, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, të përcaktojnë format dhe mënyrat e bashkëveprimit ndërmjet tyre.

6. Ngarkohet Ministria e Brendshme të nxjerrë aktet përkatëse në zbatim të këtij vendimi.

7. Efektet financiare përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Brendshme për vitin 1998.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano